

Damanek/Domanek në muajin maj të vitit 1998. Në datën 21.07.1998, me një grup ushtarësh shkuan për tu ndihmuar forcave të UÇK-së, të cilat vepronin në rrethinën e Rahovecit/Orahovac. Një ditë më vonë [22.07.1998], ai u qëllua në gjoks nga një pushkë snajperi të *Çerdhja e Shqiponjave/Orlovo gnezdo*, në vendin e quajtur *Lugina e Shqiponjave/Dolina orlova*, në *Bjeshkët e Rahovecit/Orahovačke planine* [Rahovec/Orahovac]. Po atë ditë, ushtarë të UÇK-së e bartën kufomën e tij deri te shkolla ku Ramadan punonte, ku atë e morën familjarët e tij dhe e varrosën në varrezat e Qypëves/Čupevo. Pas përfundimit të luftës, më 10.06.2001, mbetjet mortore të Ramadanit u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Malishevë/Mališevo. Shkolla, në të cilën Ramadan punonte si asistent para lufte, e emërtua sipas tij.

Burimet: deklarata A.M, FDH-35418; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Avdi (Vehbi) Hoxha

(1.02.1922, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, bujk, katër fëmijë)

Avdiu i moshuar mbeti vetëm në shtëpi, në afërsi të ambulancës, kur familjarët e tij e braktisën **Rahovecin/Orahovac** më 18.07.1998. Më 22.07.1998, një polic i pidentifikuar serb hyri në shtëpinë e Avdiut dhe e vrau atë. Po atë ditë, shërbimet komunale e kanë marrë dhe e kanë çuar kufomën e tij në drejtim të panjohur. Kufoma e Avdiut u zbulua një vjet më vonë në varrezat në afërsi të gropës me bërrilok, prapa varrezave myslimane në Rahovec/Orahovac. Familjarët e identifikuan Avdiun në bazë të orës së xhepit dhe rrobave të trupit. E varrosën në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac.

Burimet: deklarata N.N, FDH-873; deklarata N.N, FDH-879; deklarata Y.H, FDH-12931.

Remzi (Sadri) Ukshini

(17.01.1977, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, nxënës, pjesëtar i UÇK-së)

Remziu u bë anëtar i UÇK-së nga mesi i muajit maj të vitit 1998. Ka marr pjesë në

luftimet e Rahovecit/Orahovac që filluan më 17.07.1998. Bashkëluftëtarët e Remziut e panë atë të gjallë për herë të fundit më 24.07.1998, te vendi i quajtur *Carevc/Carevac* [Rahovec/Orahovac], kur ata tërhiqeshin nga sulmi i forcave serbe. Në listën e të zhdukurve të KNKK-së, rasti i tij është evidentuar në lëndën që e mban numrin BLG-802326-01.

Burimet: deklarata S.D, FDH-34338; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; OMPE, *Regjistri i konsoliduar...*, FDH-32367; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Xhevat (Imer) Kasapi

(27.12.1972, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, tregtar, pjesëtar i UÇK-së)

Samir (Selim) Nurkasa

(23.01.1973, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, bujk, një fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Gëzim (Fahredin) Mullaabazi

(3.12.1977, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, bujk, pjesëtar i UÇK-së)

Xhevati, Samiri dhe Gëzimi ishin miqtë e ngushtë. E ndihmonin UÇK-në që nga fillimi i vitit 1998, ndërkaq në muajin maj të të njëjtit vit u bënë pjesëtarë të UÇK-së. Në datën 25.07.1998, Xhevati, Samiri dhe Gëzimi kanë gjetur vdekjen në luftimet që u zhvilluan te vendi i quajtur *Te Rrasat/Ploče* [Rahovec/Orahovac]. Një ditë më vonë, bashkëluftëtarët i varrosën trupat e tyre në Malishevë/Mališevo. Pas përfundimit të luftës, më 17.07.1999, mbetjet e tyre mortore u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës [varrezat myslimane] në Rahovec/Orahovac.

Burimet: deklarata D.M, FDH-34333; SHFĐUÇK, *Feniksët...9*, 95-98; SHFĐUÇK, *Feniksët...10*, 98-101, 260-263; SHFĐUÇK, *Feniksët...12*, 207-209; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.6D00803, FDH-31372.

Ruzhdi (Xhemë) Xhyliqi

(5.12.1963, shqiptar nga Maralia/Maralija, komuna e Malishevës/Mališevo, bujk, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Habib (Halil) Berisha - Hoxha

(30.07.1965, shqiptar nga Carravrana/